

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: FINALING SH.P.K.; IDEOR CONSTRUCTION SH.P.K.; D & T Group SH.P.K., Mbreti Genc Nr. C 74-1 – PRISHTINË Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	30.10.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores **Nr. 001/2022** për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **30.10.2023**, të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: FINALING SH.P.K.; IDEOR CONSTRUCTION SH.P.K.; D & T Group SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I SHTEPISË MUZE "BAJRAM CURRI" NË KRUSHË TË MADHE**, me Numër të prokurimit: **623-23-9479-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-059-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **HEDHET POSHTË** si e pa bazuar Kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: FINALING SH.P.K.; IDEOR CONSTRUCTION SH.P.K.; D & T Group SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I SHTEPISË MUZE "BAJRAM CURRI" NË KRUSHË TË MADHE**, me Numër të prokurimit: **623-23-9479-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-059-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës: **25.10.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me hapat e më tutjeshëm për këtë aktivitetin e prokurimit
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Grup i Operatorëve Ekonomik: FINALING SH.P.K.; IDEOR CONSTRUCTION SH.P.K.; D & T Group SH.P.K. me adresë në **Prishtinë**, me datë: **30.10.2023** si palë e pakënaqur ka deponuar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK Komuna e Rahovecit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I SHTËPISË MUZE "BAJRAM CURRI" NË KRUSHË TË MADHE**, me Numër të prokurimit: **623-23-9479-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-059-5-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit, kundër Njoftimit mbi Vendim të AK-së të publikuar me **25.10.2023** në linkun <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Pretendimi ankimor i parashtruar nga Operatori Ekonomik me Nr.1:

Certifikatat ISO 4500:2018, ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015 te OE te rekomanduar per kontrat nuk jan valide (Nese kerkon ne web said te Cerftifikuesit del qe keto certifikata nuk ekzistojn).

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 1:

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 1 **nuk qëndron**.

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara sipas Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes se Tenderit, ndërsa sa i përket pretendimit tuaj se Certifikatat ISO te prezantuara nga Operatori Ekonomik i rekomanduar nuk janë valide

Shihe foto te bashkangjitura me ISO Certifikatat me validitet



Certifikon Që Sistemi i Menaxhimit Të Cilësisë Për Kompaninë:

AGE Group SH.P.K.

Avdulla Bugari p.n.

Rahovec - KOSOVË

Është konform me standartin

ISO 9001:2015

I vlefshëm në fushat e mëposhtme të aplikimit:

Kodi EA: 28-29

**Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore, renovime, demolime
te objekteve. Tregtim i materialeve ndërtimore**

Lëshimi fillestar: 11/01/2021

Lëshimi aktual: 11/01/2021

Skadencia: 10/01/2024

[Signature]
ICDQ sh.p.k. – Sheshi Sënderbej, Pallati I
Kulturës, Kat 1 – Tiranë

Drejtori



MS Certification
No. of Certificate 846

Për të kontrolluar statusin e vlefshmërisë së kësaj certifikate, vizitoni faqen e internetit www.icdq.qd dhe ju lutem kontaktoni ICDQ nga numri +355 42 250 531 ose email tek info@icdq.qd. Vlefshmëria e kësaj certifikate është subjekt i kontrollit periodik në mënyrë që të kontrollojë mirëmbajtjen e kushteve të aplikimit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë Për Kompaninë. Certifikata është efektive vetëm nëse shoqërohet me "Deklaratën e konfirmimit të vlefshmërisë", sipas parashikohet nga nenit 7.3 të Termave dhe Kushteve të Përgjithshme.



PCA
PARTNERS CERTIFICATE
ASSURANCE

Certificate

ISO 14001 : 2015

AGE group SH. P.K

Avdullah Bugari P.N Rahovec, Kosove

This certificate shows that the environmental management system of the above company was approved by PCA Certification for the following scope, the validity of the certificate depends on the company's pass the annual surveillance audits and company's maintenance the related management system conditions according to international accreditation criteria.

SCOPE

Construction of residential and non-residential buildings, water proofing and water proofing works.
Construction of roads and highways. Supply with construction materials and technical materials.
Renovations of buildings and their maintenance

Certificate No : CY-35564

Registration Date : 17.12.2021

Reissue Date : 10.01.2022

Expiry Date : 16.12.2023

Certificate Period : 3 Years (From the date of registration)

EA CODE
28

Management
Systems
Certification Body
MSCB-103

[Signature]

PCA Certification Approval

PCA Sertifikasyon Hizmetleri Limited Şirketi
Orta Mah. Ordu Sk. İşpark C Blok No:26/23 Kat:1/ İSTANBUL
Tel: +90 216 516 63 48-49 Faks: +90 216 517 63 49
www.pca-tr.com info@pca-tr.com

PR.BG Rev.4



CERTIFICATE

This certificate shows that the Occupational Health and Safety Management Systems of the company:

AGE group SH.P.K

AVDULLAH BUGARI P.N RAHOVEC, KOSOVE

Has been found to conform to the standard

ISO 45001: 2018

Approval is hereby granted for registration, provided the certification rules and conditions are observed at all times

This Certificate is valid for the following Scope:

Construction of residential and non-residential buildings, water proofing and water proofing works. Construction of roads and highways. Supply with construction materials and technical materials. Renovations of buildings and their maintenance

Decision Date: 17.12.2021

Reissue Date: 15.12.2022

Certificate Number: MK99.006



Director
AQRA Certification doo
Bulevar Oslobođenja 101
11040 Beograd, R.Srbija
www.aqracertification.rs

*This certificate is valid till 16.12.2024 as long as the system is effectively maintained and every year reissued by AQRA Certification d.o.o.
To check the validity of the certificate, please contact with AQRA Certification d.o.o through e-mail, which is given in www.aqracertification.com. This certificate is the property of AQRA Certification d.o.o. and shall be returned if requested*

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Pretendimi ankimor i parashtruar nga Operatori Ekonomik me Nr. 2:

Inxhinier i Elektroteknikes z. Shukri Rama, kontratën e punës e ka te pa Noterizuar dhe kontrata e prezantuar nuk është për projektin në fjalë

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 2:

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 2 **nuk qëndron.**

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara sipas Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit, ndërsa sa i përket pretendimit tuaj se Kontrata e Inxhinierit të Elektroteknikes është e pa noterizuar, nuk qëndron.

Shihe foto të bashkangjitur:



Republika e Kosovës
NOTER
Rasim Xh. Behluli
Rahovec

Nr. i LRP-së: 5133;
Nr. i ref.: 1151/2019;

-----KLAUZOLA PËR VERTETIMIN E DOKUMENTIT PRIVAT-----

-----VËRTETIMI I KONTRATËS-----

Me datë tetë gusht dy mijë e nëntëmbëdhjetë (08.08.2019), unë **Rasim Behluli**, Noter në Rahovec, në rrugën "Xhelal Hajda-Toni", vërtetoj se: -----

Nënshkrimet në fund të kësaj marrëveshje mbrapa këtij vërtetimi janë vënë nga:-----

1. **Shukri Rama**, nga i ati Said, i lindur me datë 20.09.1975, në Rahovec, ku edhe jeton, i identifikuar sipas letërnjoftimit me nr. personal: **1002302892**, të lëshuar nga MPB e R. së Kosovës, me datë 16.05.2018, shtetas i Republikës së Kosovës, me aftësi të plotë veprimi, në cilësinë e punëmarrëses.
2. **Roberto Denis Bala**, i lindur me 09.12.1998, në Uster, tani me banim të përhershëm në Rahovec, i cili posedon letërnjoftimin me nr. personal **1171969723**, të lëshuar nga MPB e R. së Kosovës, me datë 16.01.2015, shtetas i Republikës së Kosovës, i autorizuar në bazë të autorizimit Nr. i LRP-së: 4075/2019, nga "AGE group" SLLP.K., me seli në Rahovec, me nr. të biznesit **70920239**, në cilësinë e punëdhënësit.

Noteri konstaton se palët kanë aftësi të plotë veprimi.

Palët prezente pas paraqitjes së përmbajtjes së dokumentit privat- KONTRATË MBI PUNËN, e në prezencën e noterit DEKLAROJNË se përmbajtja e këtij dokumenti në tërësi i përgjigjet vullnetit të tyre, si edhe të njëjtën e nënshkruajnë personalisht.

Noteri konfirmon se dokumenti i palës është i shtypur në letër, i shkruar në pajtim me përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimit, që dokumenti nuk është e korrigjuar, as e ndryshuar, as e fshirë, as e nënvizuar, as e shtuar a plotësuar respektivisht as nuk është e shqyer, as e dëmtuar apo as e dyshimë nga pamja e saj e jashtme.

Noteri edhe përmbajtjen e dokumentit privat - KONTRATË PËR PUNËN pas shiqimit të bërë në dokumentin privat të parashtruar nga pala në origjinal se bashku me dokumentacionin tjetër të parashtruar në shiqim dhe e cila në kopje të vërtetuar i bashkangjitet këtij dokumenti.

SHTOJCAT në fotokopje:-----

1. Një kopje të letërnjoftimit personal të kontraktuesve dhe informatat e bizneseve; -----
Noteri vërteton se pala para se ta nënshkruaj dokumentin privat, në prani të noterit, ka deklaruar se ka qenë i udhëzuar dhe paralajmëruar mbi përmbajtjen dhe pasojave juridike të kësaj pune juridike dhe se deklaron se e ka kuptuar këshillat dhe vërejtjet e noterit në kuptim të nenit 34 të Ligjit mbi Noterinë e Kosovës, dhe se përmbajtja e këtij dokumenti privat në tërësi i përgjigjet vullnetit të tij. Pas kësaj pala në prezencën e noterit e nënshkroi dokumentin privat, pasi edhe e njëjta, në prezencën time u lexua dhe u pranua.

Kam konstatuar se pala e flet gjuhën Shqipe, se din shkrim-lexim, dhe e aftë të lexoj dhe të nënshkruaj dokumentin, ndaj për këtë edhe nuk ishte e nevojshme prezenca e dëshmitarëve, interpretit apo përkthyesit.

Kam konstatuar se pala ka zotësinë e plotë juridike dhe të veprimit dhe i autorizuar për ndërmarrjen e kësaj pune juridike e cila është lëndë e dokumentit dhe jam bindur në ekzistimin e vullnetit serioz dhe të lirë të tij për ta lidhur të njëjtin dhe se plotësisht e kupton rëndësinë dhe pasojat e punës juridike.

Dokumentin privat të palës, të hartuar në Gjuhën Shqipe, me alfabet latin, të shtypur në 3.(tre) fletë/faqe, duke vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 31-35, 40 dhe 42 të Ligjit mbi Noterinë e Kosovës, noteri e ka vërtetuar pasi që paraprakisht e ka vërtetuar se puna juridike është e lejuar respektivisht se nuk është në kundërshtim me dispozitat imperative, rregullimin juridik dhe dokeve të mira dhe pasi që është vërtetuar se i përgjigjet vullnetit të palës dhe se është e nënshkruar personalisht nga pala në prezencën e këtij noteri, në 3.(tre)ekzemplarë, nga të cilat 1.(një)ekzemplar me shtojcat mbeten te noteri dhe 2.(dy) ekzemplarë i mbanë pala. -----

Dokumenti me klauzolën mbi vërtetimin e dokumentit përbëhet nga 5.(pesë)fletë, 5.(pesë)faqe, nga të cilat 3.(tre)fletë/3.(tre) faqe e përbënë KONTRATË MBI PUNËN, i cili është i shkruar me kompjuter dhe 2.(dy) fletë/tjetra po në 2.(dy)faqe e përmbajnë Klauzolën e vërtetimit të dokumentit privat (solemnizimi) të shtypura.-----

Shpenzimet për punën e noterit janë paguar konform UA 02/12 mbi tarifat, Neni 23.-----
Veprimi i noterizimit u bë në Rahovec, në zyrën e Noterit, me datë tetë gusht dy mijë e nëntëmbëdhjetë (08.08.2019).-----


Rasim Xh. Behluli



Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Pretendimi ankimor i parashtruar nga Operatori Ekonomik me Nr. 3:

Inxhinieri i Arteve ne Menaxhimin e Emergjencave, ka kontrat me kompanin Sinani ing shpk por kompania ne fjal nuk ka prezentu vertetim nga ATK qe i njehti deshmon qe eshte puntor i rregullt i kompanis.

Inxhinieri Emin Dragusha, ka kontrat me Sinani ing shpk por kompania ne fjal nuk prezentu vertetim nga ATK qe i njehti deshmon qe eshte puntor i rregullt i kompanis.

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 3:

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 3 **nuk qëndron.**

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara sipas Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes se Tenderit, ndërsa sa i përket pretendimit tuaj se kompania ne fjale nuk ka prezantuar vërtetim nga AKT qe i njehti deshmon qe është punëtor i rregull i kompanisë, nuk qëndron, pasi qe një kriter i tillë nuk është kërkuar në Njoftim për Kontratë dhe Dosjen e tenderit, **Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.**

Po ashtu Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit ***B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar***, ku nuk e keni plotësuar këto kriter sipas Njoftimit për Kontrate/Dosjes se tenderit:

Kapaciteti teknik dhe professional:

Kërkesa 2: Operatori Ekonomik duhet te ketë ne listën te paktën këtë staf professional:

2.2. Udhëheqësi i Punishtes – Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës ose master, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit;

Dëshmia 2: • Kopje e noterizuar e kontratës së punës me punëdhënësin në prani të palëve ose marrëveshja e noterizuar mbi angazhim për këtë projekt në prani të palëve;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën: Udhëheqësi i Punishtes – Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës ose master, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, keni prezantuar z. **Kushtrim Krasniqi**;

Në Njoftim për Kontratë dhe sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe professional, nga dëshmitë e kërkuar dokumentare është kërkuar: *Kopje e noterizuar e kontratës së punës me punëdhënësin në prani të palëve ose marrëveshja e noterizuar mbi angazhim për këtë projekt në prani të palëve;*

Kontrata e punës e prezantuar me Inxhinierin në fjalë, nuk është bërë para noterit ne prani te palëve, por është bërë vetëm nga z. **Durim Shala**, tek noteri, i cili ka kërkuar që të bëjë vërtetimin e kopjeve, që rrjedhin nga dokumenti, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

2.3. Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose master - Drejtimi Hidroteknike - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit;

Dëshmia 2: • Kopje e noterizuar e kontratës së punës me punëdhënësin në prani të palëve ose marrëveshja e noterizuar mbi angazhim për këtë projekt në prani të palëve;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën: Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose master - Drejtimi Hidroteknike - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, keni prezantuar z. **Mexhid Zylfiu**;

Në Njoftim për Kontratë dhe sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe professional, nga dëshmitë e kërkuar dokumentare është kërkuar: *Kopje e noterizuar e kontratës së punës me punëdhënësin në prani të palëve ose marrëveshja e noterizuar mbi angazhim për këtë projekt në prani të palëve;*

Kontrata e punës e prezantuar me Inxhinierin në fjalë, nuk është bërë para noterit ne prani te palëve, por është Noterizuar vetëm nga z. **Afrim Morina**, i paraqitur tek noteri, i cili ka kërkuar nga Noteri vërtetimin e dokumentit, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

2.4. Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Elektroteknike ose master - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit;

Dëshmia 2: • Kopje e noterizuar e kontratës së punës me punëdhënësin në prani të palëve ose marrëveshja e noterizuar mbi angazhim për këtë projekt në prani të palëve;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën: Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Elektroteknike ose master - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, **keni prezantuar z. Ardian Ibraj**;

Në Njoftim për Kontratë dhe sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe professional, nga dëshmitë e kërkuar dokumentare është kërkuar: *Kopje e noterizuar e kontratës së punës me punëdhënësin në prani të palëve ose marrëveshja e noterizuar mbi angazhim për këtë projekt në prani të palëve;*

Kontrata e punës e prezantuar me Inxhinierin në fjalë, nuk është bërë para noterit ne prani te palëve, por është Noterizuar vetëm nga z. Afrim Morina, i paraqitur tek noteri, i cili ka kërkuar nga Noteri vërtetimin e dokumentit, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

2.5. Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Makinerike ose master - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit;

Dëshmia 2: • Kopje e noterizuar e kontratës së punës me punëdhënësin në prani të palëve ose marrëveshja e noterizuar mbi angazhim për këtë projekt në prani të palëve;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën: Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Makinerike ose master - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, **keni prezantuar z. Ramadan Buzhala**;

Në Njoftim për Kontratë dhe sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe professional, nga dëshmitë e kërkuar dokumentare është kërkuar: *Kopje e noterizuar e kontratës së punës me punëdhënësin në prani të palëve ose marrëveshja e noterizuar mbi angazhim për këtë projekt në prani të palëve;*

Kontrata e punës e prezantuar me Inxhinierin në fjalë, nuk është bërë para noterit ne prani te palëve, por është Noterizuar vetëm nga z. Afrim Morina, i paraqitur tek noteri, i cili ka kërkuar nga Noteri vërtetimin e dokumentit, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

2.6. Master ose Bachelor i diplomuar në Menaxhimin e Emergjencave, Master me Tre (3) vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i diplomuar me Pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit;

Dëshmia 2: • Kopje e noterizuar e kontratës së punës me punëdhënësin në prani të palëve ose marrëveshja e noterizuar mbi angazhim për këtë projekt në prani të palëve;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën: Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Makinerike ose master - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, **keni prezantuar z. Miftar Mehani**;

Në Njoftim për Kontratë dhe sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe professional, nga dëshmitë e kërkuar dokumentare është kërkuar: *Kopje e noterizuar e kontratës së punës me punëdhënësin në prani të palëve ose marrëveshja e noterizuar mbi angazhim për këtë projekt në prani të palëve;*

Kontrata e punës e prezantuar me Inxhinierin në fjalë, nuk është bërë para noterit në prani të palëve, por është Noterizuar vetëm nga z. Afrim Morina, i paraqitur tek noteri, i cili ka kërkuar nga Noteri vërtetimin e dokumentit, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Tek Aneksi 6. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS është kërkuar;

Afati me i shkurt i implementimit nga data e nënshkrimit të kontratës deri në maksimum: 480 ditë.

Ndërsa konform normave ndërtimore afati minimal i implementimit është: 225 ditë.

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të prezantuar, në plotësimin e Aneksit 6.1: AFATI I IMPLEMENTIMIT DHE PERIUDHA GARANTUESE, ju si Operator Ekonomik keni ofruar këtë afat të implementimit:

I. AFATI I IMPLEMENTIMIT të këtij projekti është: 200 ditë, nga data e fillimit të punëve e përcaktuar nga Menaxheri i Kontratës.

Gjë që është në kundërshtim me Kërkesën e Autoritetit Kontraktues, ku në Dosjen e Tenderit është cekur afati Maksimal dhe afati Minimal, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit